

Ministri Limani tha se ministria që ai udhëheq - do të angazhohet për flakjen e të gjitha parregullsive të bëra në të kaluarën, ndërsa do të jetë përkrah të gjitha kategorive të rezikuara në aspektin social në shoqerinë tonë

Ditë më parë, në selinë e Komunës së Zhelinës qëndroi Ministri për Punë dhe Politikë Sociale i RMV, Fatmir Limani për t'u takuar me pensionistë të degës së Zhelinës, ndërsa të pranishëm ishin edhe kryerët e Shoqatës së Pensionistëve të Tetovës, të udhëhequr nga kryetari, Selver Memeti. Ministri Limani para të pranishmëve publikoi Vendimin e Qeverisë së RMV përritjen lineare të pensioneve prej 5.000 denarësh. Pjesën e parë të rritjes pensionistët do ta marrin me pensionin e muajit shtator të këtij viti, ndërsa pjesën e dytë prej 2.500 denarësh me pensionin e muajit mars të vitit 2025. Gjatë këtij takimi ministri Limani u shpreh optimist se trendi i rritjes së pensioneve do të vazhdojë edhe gjatë viteve të ardhshme.

Ndërkaq, sa i përket interesimit të pensionistëve për ngritjen e shtëpive të akomodimit të pleqve, ministri Limani tha se do të bëhen përpjekje për gjetjen e tokës në pronësi të shtetit, e cila do t'u ndahet komunave, do të hartohen projekte me qëllim të ndërtimit të Shtëpive për pleq dhe Kopshteve

## MINISTRI LIMANI TAKIM ME SHOQATËN E PENSIONISTËVE TË TETOVËS

# ANGAZHIM PERMANENT PËR TË PËRMIRËSUAR STANDARDIN E PENSIONISTËVE



për fëmijë. Ndërtimi i objekteve të kësaj natyre është nevojë imediate e shoqërisë, madje edhe për sistemin e njerëzve të pastrehë, të cilët enden gjithandej për të kërkuar ushqim dhe strehim. Ministri Limani tha se ministria që ai udhëheq - do të angazhohet për flakjen e të gjitha parregullsive të bëra në të kaluarën, ndërsa do të jetë përkrah të gjitha kategorive të rezikuara në aspektin social në shoqerinë tonë.

Duke iu përgjigjur interesimit të pensionistëve për qëndrim në banjat shëruese të vendit, informoi se tash më janë nënshkruar marrë-

veshje me disa nga banjat e vendit, tek të cilat do të mund të qëndrojnë pensionistë, duke participuar me çmime të benificuara. Duke folur përidenë e ndërtimit të shtëpive për akomodimin e pleqve, kryetari i Komunës së Zhelinës, Blehim Sejdiu, tha se do të bëhen përpjekje për kthimin e pronës së ish "Shik-Jellakut" në Tetovë në pronësi të Komunës së Tetovës, i cili lokalitet është mjaft i përshtatshëm për ndërtimin e një institucioni për akomodimin e moshave të treta me nevojë dhe krijimin e banesave sociale. Ndërtimi i këtij kompleksi, sipas Sejdikut në masë

të madhe do ta zbuste çështjen e sistemit të pleqve dhe rastevë sociale në Tetovë e rrëthina, vlerësoi kryetari i Zhelinës Blehim Sejdiu.

Kryetari i Shoqatës së Pensionistëve të Tetovës, Selver Memeti, para të pranishmëve në këtë takim bëri një elaborim të punëve dhe aktiviteteve që zhvillohen në Shoqatën e Tetovës, e cila është e organizuar në 22 degë me mbi 14 mi pensionistë. Memeti e përgëzoj ministrin Limani për projektet inkurajuese të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale e që janë në dobitë pensionistëve. Ai shprehu gatishmërinë e zhvillimit të një bashkë-

punimi të mirëfilltë me të gjitha institucionet në vend, veçmë me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, sepse siç tha, kjo është mënyra e vetme me të cilën mund t'u ndihmohet pensionistëve, sidomos atyre me pensione të ulta. Kryetari Memeti u angazhua edhe mbi realizimin e plotë të harmonizimit të pensioneve me shpenzimet jetësore dhe rritjen e pagave të të punësuarve në sektorin publik si dhe përfshirje në listat pozitive të barërave, në veçanti atyre që përdoren për pacientë që trajtohen në repartet e ortopedisë dhe oftalmologjisë. E gjithë kjo do të ishte në të mirë të pensionistëve, të cilët e kanë të vështirë t'i mbulojnë të gjitha shpenzimet jetësore, përfshirë edhe barërat që i përdorin në vazhdimësi. Memeti po kështu kërkoi nga ministri Limani që shiteti dhe institucionet e tij të angazhohen seriozisht në ngritjen e objekteve për akomodimin e pleqve.

Ministri i Punës dhe Politikës Sociale, Fatmir Limani, gjatë takimit të tij me pensionistë në Zhelinë, paralajmëroi edhe vizita të tjera në Shoqata të pensionistëve, sepse siç tha, gjithçka që është krijuar deri më tash paraqet kontribut të njerëzve të cilët tanë janë në pension të merituar. (M. Murseli)

Profesor Resul Bekteshi është autor i disa veprave artistike dhe i disa teksteve shkolllore për shkollë filllore nëntëveçëre dhe për shkollat e mesme profesionale. Veprat e tij janë studim i përsosjes, stimulim për veprimtarë krijuar, janë veprat e shkruara me madhësinë e veprimit. Vepra "Proza Popullore Strugane" u bë një vepër e madhe prej tregimeve të shkurtra!

Nga Muamet BOROVA

Disa here leximi si aktivitet i preferuar mund të bëhet dhe duke pushuar ose thënë më mire aktivitet për pushim nga lodiha e tepert gjatë punës së rëndomtë. Leximi mund të jetë një kënaqësi e dyfishtë atëherë kur e njohim edhe autorin e librit, i cili librit ia ka dhënë strukturën dhe kompozicionin!. Edhe përkrah temperaturave përvëlues, jeta në qytet zhvillohej me një laramani aktivitetesh, duke ofruar përbajtje të ndryshme artistike për të gjitha moshat. Përadhuresit e artit letrar puhia freskuese erdhë me promovimin e librit të prof. Resul Bekteshi me titull "Proza Popullore Strugane". Libri

## RESUL BEKTESHI

# NJË LIBËR QË RELAKSON


në fjalë është një përbledhje me përralla, tregime, legjenda, anekdota, frazeologjizza e proverb që i ngjan një pylli të dendur, ku drurët janë radhitur në një harmoni të përsosur që fascinojnë me bukurinë e tyre, sidomos ne stinën e gjelbërimit.

Në atë libër çdo tregim, legjendë apo pjesë tjetër e marrë nga thesari i pasur strugan të çon të udhëtosh në një kohë të caktuar në një vend të caktuar sikur je edhe ti pjesëmarrës në atë ndodhi. Personat (subjektit) e pjesëve janë njerëzit e rëndomtë dhe fatet e tyre siç janë të varfrit, fshatarët, pra njerëzit e thjeshtë dhe përbalë tyre agallarët, mbretërit, kuçedrat etj.

Me një fjalë, pjesët e zgjedhura, të grumbulluara prej treguesve të moshave të ndryshme dhe në vende dhe kohë të ndryshme - përbajnjë vitalizimin e një organizmi të gjallë që të nxit dhe të ngre lartë ndjenjat e thella idile të jetës. Varësisht nga ngjarja përfundimtare e tij, që të cilën flitet në tregim ose legjendë a përrallë, gjuha e përdorur aty apo zhargoni rrëfimin e bëjnë më autentik dhe tërheqës. Gjatë leximit të tregimeve fitohet përshtypja sikur në mënyre telepatike bisedojmë me një plak (person) të panjohur, i cili përcjell

kujtimet për ndodhitë nga kohërat e kaluara. Stili më të cilin janë shkruar tregimet (pjesët) që janë përcjellë nga të tjerët e pasqyrojnë punën e palodhshme të autorit. Në legjendën: "Martesa e Aga Ymerit "Njihemini me personalitetin, guximin dhe besnikërinë, karakterin e forte të Aga Ymerit i cili që natën e parë të martesës që i detyruar të lëne familjen dhe të shkon ushtar. Pasi e mori lamtumirën e nënës dhe besën e gruas niset për në ushtri. Atje bie rob lufte dhe bën nëntë vjet nëpër zandanët e mbretit. Pas nëntë vitesh sheh një èndërr dhe bie në depresion - "as hante as pinte dhe çiftelisë më si binte". Vajza e mbretit e vërejtet këtë, prandaj pasi mori premtimin nga Aga Ymeri së për tre ditë do të kthehet, ajo e lëshoi Agën të shkoj në familje. - Aga Ymeri shkoi në shtëpi, u përshtendet më nënën, ktheu nusen në shtëpi dhe u kthye te mbreti për të kryer burgun. Besën që e dhe e mbajti, prandaj mbreti ia faljet jetën. Këtu vërehet vlera institucionale e fjalë së dhënë besa - si vlerë e lartë kombëtare e jona. Ky është një mesazh i fuqishëm përmbytjen e dinjitetit moral.

Në këtë libër ka shumë tregime që duke



i lexuar në imaginatën tonë e rivendosin harmoninë midis asaj që mendojmë dhe realitetit. Çdo tregim ka një porosi të veçantë. Për të kuptuar vlerën artistike dhe letrare të këtij libri është më se e nevojshme të uleshë e të lexosh pjesët të tjerë, sepse ata edhe relaksojnë, shpëlodhën mendjen nga lodiha e punëve ditore. Profesor Resul Bekteshi është autor i disa veprave artistike dhe i disa teksteve shkolllore për shkollë filllore nëntëveçëre dhe për shkollat e mesme profesionale. Veprat e tij janë studim i përsosjes, stimulim për veprimtarë krijuar, janë veprat e shkruara me madhësinë e veprimit. Vepra "Proza Popullore Strugane" u bë një vepër e madhe prej tregimeve të shkurtra!